



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E TIRANË  
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT  
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR  
(PARAPRAK)**

**Drejtuar:** Operatorit ekonomik “PROSOUND” shpk

**Adresa:** Rruga e Kavajes, ish Misto Mame, Zona Kadastrale 8240, Tiranë

\* \* \*

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar/ Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.**

Numri i procedurës: **Nr.REF-10805-06-24-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Shpenzime për qiramarrje për aparate dhe pajisjet teknike, makineri (foni,pajisje ndricimi,videoprojektor, karrige,stage, stenda)”**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr.34, datë 01 Korrik 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. “SCREEN AD”shpk**

**NIPT-t : L11326001A**

Vlera e ofertës: **2 210 000** (dymilion e dyqind e dhjetëmijë) lekë pa Tvsh

**2. “PROSOUND” shpk**

**NIPT-t: K623200120**

Vlera e ofertës: **2 999 000** (dymilion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntëmijë) lekë pa Tvsh

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**1. “SCREEN AD”shpk**

**NIPT-t : L11326001A**

Vlera e ofertës: **2 210 000** (dymilion e dyqind e dhjetëmijë) lekë pa Tvsh

**arsyet e mëposhtme:**

Operatori Ekonomik ka paraqitur Formularin sipas Shtojcës 2 në të cilin ka ofertuar me çmime për zërat 1-6 të preventivit të vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor duke mos paraqitur ofertën e tij për zërat sa më poshtë:

Zëri 7: Pajisje ndriçimi (ndriçim i kompletuar, jo më pak se 40 njësi ndriçimi. Psh: ndriçues linear, ndriçues ëash rgb, ndriçues me kokë të rrotullueshme, pult ndriçimi etj).

Zëri 8: Pedana me sipërfaqe të ndryshme (për aktivitete të mëdha) 60 m<sup>2</sup>

Zëri 9: Pedana me sipërfaqe të ndryshme (për aktivitete të vogla) 30 m<sup>2</sup>

Pra në rastin konkret, nga verifikimi i listës së cmimeve të paraqitur nga operatori ekonomik Screen AD, konstatohet, se paraqitja dhe plotësimi i zërave të tij nuk është bërë konform përcaktimit të preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor në shtojcën 2 të dokumentave të tenderit. Ndodhemi në kushtet kur llogaritja e vlerës e pasqyruar në formularin e ofertës duhet të ishte përlllogaritja e shumave të pasqyruara në listën e çmimeve përkatësisht shumat 1+2+3+4+5+6+7+8+9 ndërkohë përlllogaritja e bërë nga operatori ekonomik është për shumat 1+2+3+4+5+6

Në dokumentet standarde të tenderit, është e përcaktuar në seksionin I Udhëzime për operatorët ekonomikë PËRGATITJA E OFERTAVE, pika 4. “Formularët e tenderit dhe preventivat e Çmimeve: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar” ndërsa në pikën 6 “Çmimet” është përcaktuar se: **“Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës”.**

Sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon, se operatori ekonomik ndodhet në kushtet e përlllogaritjes së ofertës ekonomike në kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi pasi nuk ka ofertuar sipas të gjithë zërave referuar listës së cmimeve të kërkuar nga autoriteti kontraktor në përlllogaritjen totale të ofertës ç’ka përben kusht për skualifikim.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik : **“PROSOUND” shpk**, me adresë: Adrese: Rruga e Kavajes, ish Misto Mame, Zona Kadastrale 8240, Tiranë se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **2 999 000** (dymilion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntëmijë) lekë pa Tvsh, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.